



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**  
Nr. 02-060/01-0076942-1/23 dt. 26.10.2023  
Mitrovicë

**PROCESVERBAL**  
**Nga mbledhja e 25-të e rregullt e Kuvendit të Komunës**

**Koha:** 26.10.2023 ora 10:00

**Vendi:** Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

**Të pranishëm:** Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Hamdi Hasani, Mentor Vinarci, Nazmije Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Egzon Hamza, Nafije Rexha, Faruk Mujka, Hysen Muzliukaj, Kushtrim Zeneli, Jeton Zeneli, Armend Begu, Ekrem Sadiku, Naser Muja, Shkurta Shosholli Musa, Elidiana Budini Haziri, Erseka Barani, Xhevrije Bahtiri Ademi, Xhyljeta Imeri, Flutura Beka Kamberaj, Sevdaim Uka, Gazmend Asllani, Muhamed Hoti, Oltion Ahmeti, Jeton Ujkani, Vesel Neziri dhe Gjergj Beka

**Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza**  
**Nënkryetari i Komunës z. Arian Tahiri**  
**Drejtorët e Drejtorive**  
**Përfaqësues të Shoqërisë Civile**  
**Mediat**  
**Mungoi:** Lavdim Zeneli dhe Ardita Aliu

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit znj. Vesa Broja, e cila fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës ka thirrur mbledhjen e 25-të të rregullt të Kuvendit të Komunës me rendin e ditës të paraparë me thirrje. Konstatoj se të pranishëm janë 31 anëtarë.

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Kryetari i Komunës Z. Bedri Hamza: Përshëndes gjithë të pranishmit, nëse e kemi për krahen e Asamblesë, propozoj që të vendosen edhe dy pika të reja të rendit të ditës. Pika e parë e rendit të ditës ka të bëjë me Transferimin e shumave të ndara buxhetore, bazuar në nenin pesëmbëdhjetë të Ligjit të buxhetit, që do të thotë Ligji i buxhetit, neni pesëmbëdhjetë, e jep mundësinë që organizatat buxhetore në fund të vitit në tremujorin e fundit të vitit fiskal, mjetet ku ka tepriçë, të vendosen në pozicionet aty ku ka nevojë dhe ku ka mungesë, lejohet edhe transferi prej Organizatës Buxhetore në Organizatën Buxhetore, kjo ka ndodhë vazhdimisht, kemi pranuar shkresë prej Ministrisë së Financave, afati i dorëzimit të këtij propozimi dhe të kësaj kërkesë është i shkurtë, është me datën njëzet e shtatë, që do të thotë është nesër dhe ne si Komunë e Mitrovicës për shkaqe objektive kemi nën shpenzim në disa pozicione dhe këto mjete mund t'i përdorim në disa projekte tjera, të cilat janë në vijim. Pse ka ardhur deri te shpenzimi, shumica e këtyre projekteve, do tu vijjnë edhe juve si asamblist, do t'ju shpërndahet materiali tash, secili projekt që ndikohet, edhe negativisht, edhe pozitivisht, janë se janë në OSHP. Unë nuk po them që s'janë duke punuar ata të OSHP-së, por ndoshta janë të mbingarkuar, është e drejtë ligjore, kushtetuese e secilit që ta shfrytëzojë të drejtën e vetë ankesës, mirëpo afatet për përgjigje prej OSHP-së, jo që janë kaluar, po janë kaluar për shumë herë në raport me ligjin, por ne ende sot s'kemi përgjigje, domethënë dhe për këtë qëllim, unë konsideroj që këto shuma të transferohen në projektet në vijim dhe do të jenë të specifikuar në materialet që do t'i merrni që mos tu marr kohën më shumë.

Pika e dytë është një kërkesë, besoj që kemi me pas përkrahjen e Asamblesë, që ka të bëjë me vendim për miratimin paraprak të hapësirës publike komunale për vendosje të shtatores, si simbol në nderim të ish-futbollistit Mitrovicas, Erion Kajtazi. Një djalë me perspektivë, fatkeqësisht në moshë të re ka ndërruar jetë, pra kemi një kërkesë prej klubit futbollistik Trepça'89 që të ndahet një hapësirë publike te fusha ndihmëse e stadiumit të Trepça'89 që të lejohet vendosja e një shtatoreje. Pra këto ishin dy pika shtesë, nëse e kemi përkrahjen e Asamblesë Komunale që të futen si pika të rendit të ditës do të isha mirënjohës.

Xhevrije Bahtiri Ademi: Kryetar e di që jeni në dijeni për pjesën në Lagjen e Bajrit, që po bëhet shembja e dheut. Ata banorë sot më kanë kërkuar që ta ngris këtë çështje edhe një herë në Kuvend, e di që jeni në dijeni të gjithë, por duke e ditur që tash mundet me pas të reshura të shiut apo borës dhe ajo pjesë e banuar po rrezikohet. A mundemi ta fusim si pikë të rendit të ditës dhe ne si asamble të dalim me një kërkesë që të ju dalim në ndihmë atyre banorëve, se vërtet rreziku është shumë i madh.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Sa i përket çështjes që e ngritet znj. Bahtiri Ademi, keni shumë të drejtë, është një problem jashtëzakonisht serioz, ka pasur raste ku prej fatkeqësive natyrore, dhe po prej zhvillimeve të ndryshme njerëzive i kanë humb shtëpitë, por nuk e kanë humb truallin. Rasti konkret është që kanë humbë edhe shtëpia edhe truallin. Unë kam pas takim me ata banorë, i kam vizituar, aty është bërë jeta e pamundshme, d.m.th njerëzit i kanë braktis shtëpitë e tyre, dhe është rrezik për jetë. Edhe dy çështje që ju i keni përkrahë si Asamble, na i kemi nda në buxhet për vitin e ardhshëm dhe janë pozicion i veçantë që secilës prej atyre familjeve që janë të ndikuara nga kjo fatkeqësi, unë e di që s'është krejt kompensimi i dëmit, secilës familje t'i ndahen nga 10.000 € prej buxhetit të komunës. Kemi shkruar shkresa në nivelin qendror, janë të informuar, jemi në komunikim për të parë se a kanë mundësi me na ndihmuar. Përtej kësaj, ne pritët këto ditë, se është në fazën finale, të nënshkruhet një kontratë për intervenime emergjente dhe përmes kësaj kontrate, në bazë të analizave dhe propozimeve të ekspertëve të fushës, ne t'i bëjmë edhe intervenimet e nevojshme, nëse ka mundësi që ajo pjesë të stabilizohet. Prandaj, ne mund të mbajmë edhe mbledhje të jashtëzakonshme apo mbledhje të rregullt edhe ta fusim si pikë të rendit të ditës, po prapë po e them duke ju falënderuar përkrahjes juaj, na si komunë brenda kapaciteteve tona kemi reflektuar dhe i kemi nda në rastin e aprovimit të buxhetit dhe operacionalizimit të buxhetit për vitin 2024, secila prej atyre familjeve do të kompensohet me nga 10.000 € dhe ne do të intervenojmë përmes kontratës që pritët me u lidhë këto ditë që t'ju ndihmojmë në stabilizimin e truallit në atë pjesë.

Vesel Neziri: Shqetësimi im ka të bëjë me një ngjarje që po ndodh ditët e fundit në Qytetin tonë, konkretisht në minierën e Trepçës. Unë kisha kërkuar nga Kuvendi që të formojmë një delegacion dhe të shkojmë aty dhe t'i shohim kërkesat dhe gjendjen shëndetësore të minatorëve në grevë. Nuk kam pritë që pas 34 viteve të e ngrisë këtë shqetësim sikur se që e kam ngritë para 34 viteve si studentë, nuk kam pas dëshirë të ndodhë kjo, po kjo po ndodh, kisha kërkuar që nga partitë politike të kenë nga një përfaqësues dhe të shkojmë të shohim gjendjen dhe shqetësimet e minatorëve.

Kryesuesja Vesa Broja: Po besoj që propozimi për krijimin e një delegacioni apo një grupi joformal, i cili mundet të shkojnë për vizitë pas seancës edhe siç e propozove, me pas përfaqësues nga gjitha partitë politike mundet me u diskutuar edhe pas seancës.

Hysen Muzliukaj: Kryetari propozoj një pikë të cilën nuk e kemi materialin, lidhur me mjetet e transferit. Sa e kuptova unë, thotë që data 27 është data e fundit, nëse na sot e marrim vendimin, a ka për të shkuar ky vendim në MAPL dhe të pritët ligjshmëria apo po vjen veç si dokument me u votua, që të thirreni në atë se është votuar. Domethënë veç ta kemi të qartë procesin. Nëse sot votohet, a ka me pas proces të ligjshmërisë së këtij vendimi, a mundemi të arrijmë në kohë për këtë çështje.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Me shumë të drejtë shtruat këtë çështje, po zakonisht, sa i përket konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, kur kanë të bëjnë me çështjet financiare dhe buxhetin, ministria i drejtohet Ministrisë së Financave. Domethënë, edhe Ministria e Financave në këtë rast është më kompetente me e konstatuar ligjshmërinë e këtij procesi. Aty thotë që mundet, domethënë afati është tridhjetë ditë, por mundet me bo edhe në ditën e parë, mundet me bo në ditën e dytë, është çështje e komunikimit ndërqeveritar. Sigurisht se Ministria e Financave nuk procedon diçka tutje në qeveri për pa u plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Prandaj, është çështje që ata do ta trajtojnë, na e kryejmë punën tonë, e bëjmë propozimin tonë dhe mbetet në autoritet, në diskrecion dhe në kompetencë të nivelit qendror si do të procedojnë tutje. Unë as nuk e kam informacionin, as nuk mundem të ditë se në cilën mbledhje të Qeverisë ata kanë me fut në rend të ditës. A e

fusin në javën e parë të nëntorit apo të dytën nuk e di, por na e kryejmë punën tonë, e procedojmë lart, pastaj mbetet në diskrecion tyre se kur e procedojnë ata.

Flutura Beka Kamberaj: Unë kërkoj nga Komisioni i Ndërmarrjes “Omi Sporti” në muajin e ardhshëm, për seancën e ardhshme të na e sjellë një raport të hyrave, shpenzimeve, llogarive të arkëtueshme, të pagueshme dhe sqarimet e tjera për zërat e tjerë bilancor.

Faruk Mujka: Kjo pika e fundit është kërkesë legjitime e kryetarit, nuk është as hera e parë e nuk do të jetë e fundit, po në njëfarë mënyre, kështu duke u bazuar në këtë eksperiencë, i bie që është një keq planifikim i buxhetit, i projekteve, po të gjithë e dimë që ka vonesa në OSHP, këto vonesa janë së paku qe 10 vite dhe të gjithë jemi ballafaquar me vonesat e OSHP-së edhe unë nuk ma merr mendja që grupi jonë do të ketë ndonjë tendencë me e bllokuar këtë çështje, së paku as nuk do tentojmë me jep ndonjë lloj arsytimi pastaj për të tjerat, por gjithsesi jemi në përcjellje të projekteve dhe mandej diskutojmë edhe për zhvillimin e projekteve edhe pse znj Kryesuesë thatë që materialin tash do të na e sjellni, por mirë do të ishte sikurse materiali të kishte qenë paraprakisht këtu, që të dimë se çfarë po diskutojmë e mandej me vendosë në bazë të asaj se çfarë po shohim në material. Sa i përket kërkesës për pikën e dytë, mendoj që të gjithë pajtohemi pa dyshim dhe as që duhet për tu diskutuar ajo çështje. Ndërsa propozimit për vizitë në Trepçë, kjo është politike, këto janë kërkesa për rritje të pagave në këtë kohë të presioneve të ndryshme politike e të hyjmë në lojë politike e cila është jashtë domenit tonë, nuk ma merr mendja që na bën nder. Askush askënd, nuk e ndalon për të shkuar në vizitë në Kombinatit Trepça, sa herë që kemi pas dëshirë kemi shkuar dhe shumë mirë na kanë mirëpritur punëtorët, sindikata, menaxhmenti. Ndërsa kjo mënyrë që po kërkohet këtu është tendencioze. Kështu që nuk kisha dashtë më shumë me u përfshi këtu.

Kryesuesja Vesa Broja: Sa i përket materialeve të dy pikave, njërin material e keni para vetes, për tjetrën pikë do të kërkoj që të futet në rend dite para pikës: Pyetje dhe përgjigje për arsye që të keni kohë pak që të shihni se çfarë përmban materiali, i cili tash për pak do të ju silltet. Ndërsa sa i përket çështjes së shkuarjes në Trepçë, është çështje e cila mbetet në vullnetin e secilit këtu, propozimi ishte që të shkohet bashkërisht por papë me marrëveshje e lëmë që të diskutohet pas seancës të Kuvendit.

Vesel Neziri: Ne këtu kemi ardhur nga politika, dhe nuk është çështja e ngritjes së pagës por ata nuk po i marrin pagat dhe për këtë është greva.

Kryesuesja Vesa Broja: Ju lutem për këtë temë mos të ketë më diskutime, vullneti i lirë është i të gjithëve kush dëshiron të shkoj për vizitë andaj u dakorduar që për këtë çështje të diskutojmë pas seancës.

Ekrem Sadiku: Propozimi për hapësirën për shtatoren e të ndjerit Erion Kajtazi, të gjithë jemi për, por mua më intereson se ku ka me qenë lokacioni, a e keni hulumtuar atë pjesë, për shkak se aty është shumë afër Ibrit dhe mundet me na shkaktuar probleme, mundet me qenë edhe i Ministrisë të Ambientit, apo saktësisht Departamentit të ujërave kjo pjesë.

Edison Tërnavë: Përshëndetje për të gjithë. Kërkesa ka qenë prej Klubit Futbollistik Trepça 89. Lokacioni është pranë stadiumit Erion Kajtazi, domethënë është një hapësirë rreth dy 2m<sup>2</sup>, që nuk ka me pas pengesë as për kalimtarët, as për asgjë, por ka me qenë pjesë përcjellëse e stadiumit që e simbolizon emrin e tij Erion Kajtazit, pra nuk është në pjesën dhe ku ka të bëjë me të mirat e ujërave. Pra do të jetë në anën buzë stadiumit, jo në anën e djathtë, po përballë, ku nuk pengon.

Faruk Mujka: Ju lutem mos ta merrni për të keq pyetjen e drejtorit, sepse ne këtu si Kuvend e kemi dhënë atëherë tokën për shfrytëzim për ndërtimin e pishinës dhe gjysma është e komunës, gjysma në pjesën tjetër ka qenë e ministrisë. Kështu që nuk është aspak ideja mos të ipet toka, po veç me pas të qartë kompetencën e komunës, apo mos po duhet me marrë leje prej Ministrisë. Sepse një pjesë e shtratit të lumit Ibër, i takon Departamentit të Ujërave.

Edison Tërnavë: Për mos me pas ne telashe me ministrinë, për të mos shkuar në procedura të mëtutjeshme, kemi vendosë dy 2m<sup>2</sup>, që është pjesë komunale, që është pranë stadiumit të Erion Kajtazit.

Erseka Barani: Kam pritë që në materialin e kësaj seance të kemi një raport lidhur me gratë e prekura nga kanceri i gjirit në Komunën e Mitrovicës, njëkohësisht si pikë e rendit të ditës, në qoftë se nuk mund të përgatitet për këtë Kuvend, kërkoj që për seancën e radhës Drejtoria e Shëndetësisë të na e sjell një raport me statistikat e grave të prekura nga kanceri i gjirit në Komunën e Mitrovicës dhe sa përkrahen nga Drejtoria për Shëndetësisë.

Fahri Shabani: Jemi në muajin e fushatës për ndërgjegjësimin kundër kancerit të gjirit, raport Drejtoria e Shëndetësisë mund të japë vetëm nga të dhënat e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, sepse siç dihet raportimi i sëmundjeve nuk bëhet në Drejtorinë për Shëndetësi, bëhet në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe ata i kanë të dhënat për numrin e qytetarëve të prekur nga kanceri i gjirit dhe nga të gjitha sëmundjet. Unë sot i kam këtu të dhënat, mund ta jap si informatë dhe besoj është e mjaftueshme si informatë, nuk ka nevojë me bë raport të veçantë, por prapë si të vlerësoni ju.

Kryesuesja Vesa Broja: Është e qartë që mundet me japë si informatë drejtori për këtë seancë, po unë po propozoj që të na sillet një raport ashtu siç e kërkuat për seancën e ardhshme, duke marrë parasysh që edhe në ora 13:00 e kemi marshin dhe pastaj mbledhja mund të tej zgjatet dhe e kemi të pamundshme me dal në marsh.

Xhevrije Bahtiri Ademi: Unë e kam një kërkesë për ju Kryesuese, se ne që punojmë në arsim e kemi marrë ditë lirë ashtu siç jemi dakorduar në fillim të mandatit që mbledhjet të mbahen ditën e enjte dhe në bazë të asaj e kemi rregulluar programin e orëve në shkollë dhe që disa mbledhje nuk po thirren për ditën e enjte të fund muajit dhe ne pastaj po kemi humbje të orëve. Pra ju kisha lutur t'i përmbaheni atij orari.

Kryesuesja Vesa Broja: Po e vërtetë, vetëm se nganjëherë po bien dita e mërkurë e mbajtjes së KPF në mes të muajit dhe mandej nuk po mundem me organizuar edhe me KPF kështu që nganjëherë po duhet edhe të bëjmë ndryshime të ditëve për shkak të datave, atëherë meqenëse nuk kemi të lajmëruar për diskutim lidhur me rendin e ditës e hedh në votim propozimin që Propozim vendimi për transferin e shumave të ndara buxhetore, të hyjë si pikë e 10-të e rendit të ditës së kësaj mbledhjeje.

**Rezultati i votimit: 24 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja konstatoi se u miratua propozimi që Propozim vendimi për transferin e shumave të ndara buxhetore të futet si pikë e 10-të.**

Kryesuesja Vesa Broja hedh në votim propozimin që Propozim vendimi për miratimin paraprak të hapësirës publike komunale për vendosje të shtatores, si simbol në nderim të ish-futbollistit të Mitrovicës Erion Kajtazi, të hyjë si pikë e 11-të e rendit të ditës së kësaj mbledhjeje.

**Rezultati i votimit: 31 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja konstatoi se unanimisht u miratua propozimi që Propozim vendimi për miratimin paraprak të hapësirës publike komunale për vendosje të shtatores, si simbol në nderim të ish-futbollistit të Mitrovicës, Erion Kajtazi, të futet si pikë e 11-të.**

Në vazhdim Kryesuesja e Kuvendit vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Propozim për miratimin e Rregullores për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 07/2023 Për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në Komunën e Mitrovicës së Jugut
3. Propozim-vendim për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023/2024
4. Propozim-vendim për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave
5. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Klubin e Xhudos "Trepça", pa procedura konkurrimi
6. Propozim-vendim për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-44690/9 dt. 29.06.2023
7. Propozim për miratim të Planit komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Mitrovicën Jugore 2023-2025
8. Raporti financiar për periudhën janar-shtator 2023
9. Raport i Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave Lokale
10. Propozim vendim për transferin e shumave të ndara buxhetore
11. Propozim vendim për miratimin paraprak të hapësirës publike komunale për vendosje të shtatores, si simbol në nderim të ish-futbollistit të Mitrovicës, Erion Kajtazi
12. Pyetje dhe përgjigje

**Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja konstatoi se me shumicë votash është miratuar rendi i ditës.**

## Pika 1

Kryesuesja e Kuvendit hapi diskutimin lidhur me procesverbalin nga mbledhja e 24-të të Kuvendit të Komunës.

Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja e Kuvendit hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së 24-të.

**Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 1 abstenime.**

**Procesverbali nga mbledhja e 24-të e Kuvendit të Komunës u miratua me shumicë votash.**

## Pika 2

Kryesuesja e Kuvendit sa i përket sqarimit të Propozimit për miratimin e Rregullores për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 07/2023 Për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe parashikimet për vitet 2025-2026, fjalën ia kaloi drejtoreshës z. Elvis Feka.

Elvis Feka: Pas hyrjes në fuqi të Rregullores Nr. 07/2023 Për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në Komunën e Mitrovicës së Jugut, kemi vërejtur shumë mangësi dhe na janë shfaqur pengesa të mëdha në zbatimin e saj, prandaj me kërkesë të Drejtorisë së Inspeksionit, si dhe pas shumë kërkesave të përfaqësuesve të bizneseve, kemi vendosur të propozojmë plotësimin dhe ndryshimin e saj si në vijim:

Neni 8 paragrafi 3, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

3. Shoqëritë Tregtare sipas nenit 8, paragrafi 8.1 dhe 8.2, të shtunave do të punojnë sipas orarit të përcaktuar të punës, ndërsa të dielave nuk do të punojnë, me përjashtim të ndërmarrjeve publike.

Neni 9 paragrafi 5, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

5. Gjatë ditëve të shtunave Shoqëritë Tregtare, sipas nenit 9, paragrafi 1,2,3,4, do të punojnë sipas orarit të përcaktuar gjatë ditëve të punës, ndërsa të dielave nuk do të punojnë, përjashtim kodet e veprimtarisë 10 (përpunimi i produkteve ushqimore)

Neni 10, paragrafi 2, fshihet në tersi sepse është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 10.

Neni 11, paragrafi 2, fshihet në tersi sepse është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 11.

Neni 12 paragrafi 4, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

4. Gjatë ditës së diele Shoqëritë Tregtare, sipas nenit 12, paragrafi 12.1, 12.2 dhe 12.3 nuk do të punojnë, përjashtim mund të ketë vetëm kur iu lejohet me pëlqimin e organit kompetent të Komunës për raste të arsyeshme.

Neni 13 paragrafi 3, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

3. Përjashtim nga neni 13, paragrafi 13.1 dhe 13.2, pikat e shitjes së derivateve me pakicë së bashku me njësitë përcjellëse (marketet dhe restaurantet) mund të punojnë 24/7 (pa ndërprerje për çdo ditë të javës).

Pas paragrafit 3 shtohet paragrafi një paragraf i ri si në vijim:

Autolarjet, Auto parkingjet dhe barnatoret bujqësore, të dielën mund të punojnë sipas orarit të ditëve të punës.

Neni 15 paragrafi 2, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të veprimtarive shërbyese të ushqimit dhe pijeve, restaurantet dhe veprimtaritë shërbyese lëvizëse të ushqimit, ndarja 56, grupi 56.1, 56.2 dhe 56.3 me klasat e këtyre grupeve, fillon:

2.1. Periudha verore, prej orës 06:00 deri në orën 00:00;

2.2. Periudha dimërore, prej orës 07:00 deri në orën 23:00;

Neni, 15 paragrafi 3, fshihet në tersi sepse është bërë pjese në paragrafin 2 të nenit 15.

Neni 20, paragrafi 2, fshihet në tersi sepse është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 20.

Neni 21, paragrafi 2, fshihet në tërësi sepse është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 21.

Neni 22, paragrafi 3, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

3. Gjatë ditëve të shtune shoqëritë tregtare, sipas nenit 22, paragrafi 1 dhe 2 do të punojnë me orar të ditëve të punës, ndërsa të dielave nuk do të punojnë.

Neni 23, paragrafi 5, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

5. Shoqëritë Tregtare sipas nenit 23, paragrafi 2 dhe paragrafi 4, të shtunave do të punojnë sipas orarit të përcaktuar të ditëve të punës, ndërsa të dielave nuk do të punojnë.

Neni 25, paragrafi 3, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

3. Gjatë ditëve të shtuna shoqëritë tregtare nga paragrafi 1 i nenit 25, do të punojnë sipas orarit të përcaktuar të ditëve të punës, ndërsa të dielave nuk do të punohet.

Neni 25, paragrafi 4, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

4. Gjatë ditëve të vikendit shoqëritë tregtare nga paragrafi 2 i nenit 25, do të punojnë sipas orarit të përcaktuar të ditëve të punës, me përjashtim të ndarjes 96, klasa 96.02, klasa 96.03 dhe 96.04 do të punojnë 24/7.

Neni, 25 paragrafi 5, fshihet në tersi sepse është bërë pjese në paragrafin 4 të nenit 25.

Neni 26, paragrafi 2, fshihet në tersi sepse është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 26.

Neni 28 paragrafi 2, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

2. Kërkesat për zgjatje të orarit duhet t'i parashtrohen Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritime Evropiane, së paku 48 orë më parë dhe duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

2.1. Certifikata e regjistrimit të biznesit.

2.2. Letërnjoftimi i pronarit apo autorizimi i parashtruesit.

2.3. Pëlqimi për kushtet minimale teknike nga Drejtoria e Inspektionit.

2.4. Pëlqimin nga Këshilli i lagjes (ndërtesës), për veprimtarinë që operon në objekte kolektive.

2.5. Për rastet e ndërtimit të ulët dhe të lartë, pëlqimi ipet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizimit.

Pas nenit 32, shtohet një nen i ri 32.A si në vijim:

Pezullimi i përkohshëm i dispozitave të kësaj Rregulloreje:

1. Shoqëritë Tregtare që kanë kontrata për kryerjen e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve për institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal, nuk vlejnë dispozitat e kësaj Rregullore deri në përfundimi e kontratës.

2. Në rrethana të caktuara sipas vlerësimit të Kryetarit të Komunës, pas rekomandimit të drejtorive dhe organeve përgjegjëse, Kryetari i Komunës mund të pezullojë përkohësisht zbatimin e dispozitave të caktuara të kësaj Rregullore dhe të përcaktoj me vendim orarin e përkohshëm brenda vitit kalendarik për veprimtarinë e caktuara.

Në nenin 33, shtohet një paragraf i ri si në vijim:

3. Në rastin e pagimit të gjobës për kundërvajtje sipas nenit 33.1, në afatin e përcaktuar me urdhrin kundërvajtës, i dënuari lirohet nga pagimi 50% nga shumata e gjobës së shqiptuar.

Kryesuesja hapi diskutimin.

Hysen Muzliukaj: Sa i përket Rregullores për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 07/2023 Për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në Komunën e Mitrovicës së Jugut edhe në mbledhjen për KPF e kam cekur që mungojnë disa dokumente siç është 1. Nuk ka deklaratë financiare të bashkangjitur në këtë dokument. 2. S'ka opinion ligjor ky dokument dhe 3. Ta keni me dije se nuk bën edhe me bë plotësim-ndryshimin e saj dhe me u zbatuar i njëjti në terren, sepse është konflikt interesi. Këtu kemi të bëjnë me drejtorin e Inspektionit, i cili është pjesë e komisionit. Unë po kërkoj prej kolegëve të jenë të sinqertë, a është e vërtetë se sot diskutimi i drejtorit për ndryshim të Rregullores ka zgjatë më shumë se sa atë ditë kur e kemi votuar. Esenca e kësaj është se nuk ka dokument, Kryetari e dinë se ka qenë Ministër i Financave që nuk ka Rregullore pa deklaratë financiare. Pra më tregoni cili është implikimi buxhetor këtu, si mund të thoni se nuk ka kur e keni rritë orarin e punës nga dy orë. A do ta bëjnë kërkesën tek ju për pagesë? Cili është opinionin ligjor që ju ka thënë juve që e keni mirë? Ka Zyrë ligjore në këtë komunë e jo të na qitni neve anëtarëve para sfidave sepse kjo punë është hajgare. Në këtë Rregullore ka ndryshim të madh drastik. Ju me këtë ndryshim nuk jeni duke punuar në të mirën e qytetarëve, qytetari një shishe ujë që e blen 0.25 cent ju po doni që ai ta blej në Hip Petrol 1€. Pastaj na u tha se ka shumë kërkesa, unë në material nuk shoh që kemi

numër të madh të kërkesave andaj nga të gjithë kërkoj që sot kjo pikë mos të votohet. Për bindjen time kjo është Rregullore e re, kush ju përcakton juve tre personave kompetent përballë 35 anëtarëve që ne e votojmë këtu, nuk do të thotë që ju jeni më të mençur se ne, andaj dokumentet janë ato që e përcaktojnë a është në rregull apo jo. Këtë punë e ka Zyra Ligjore, a iu keni drejtuar Zyrës Ligjore, demantoni me argumente, herën e parë kur na e keni sjellë ka pas opinion ligjor kjo Rregullore, ka pasur implikim financiar kjo Rregullore. Pse sot po duam ta bëjmë plotësim-ndryshimin pa opinion ligjor, pa deklaratë financiare? Unë s'po mundem me e kuptuar se çka është kjo nguti. Nëse mendoni që marketet e pompave me punuar atëherë po ju themi edhe marketeve të vogla hapni edhe ju dyqanet dhe fitoni ju më mirë, sepse në këtë rast ju po punoni për oligarkë. Edhe një herë po e theksoj se nuk jam kundër askujt mirëpo nuk është kjo Rregullore ajo e cila kemi jep të gjithë kontributin tonë dhe të vije sot me këto ndryshime të cilat u theksuan nga drejtori andaj po ju kërkoj që mos ta votoni këtë pikë, të tërhiqet dhe të na vije në seancën e ardhshme me plotësimin e dokumenteve të nevojshme dhe mos të anashkalohej Zyra Ligjore për interpretim.

Erseka Barani: Atëherë unë desha me e pyet drejtorin se si do të trajtohen barnatoret, të cilat kanë punuar me kujdestari ditën e diel?

Faruk Mujka: Nuk është që kjo Rregullore ka ardhur ad hoc, gati një vit është punuar, është shtuar copa-copa dhe kemi menduar të gjithë që e kemi bërë më të mirën dhe komisioni që e ka hartuar ka qenë i propozuar prej të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Domethënë, ai vendimi i parë njëfarë mënyre i ka shërbyer edhe po del që ka qenë një vendim popullist për me dalë që ne po brengosemi për qytetarët, të dielën po ua japim pushim. E tash kur është rritë numri i kërkesave të bizneseve, atëherë i kemi anashkaluar përfaqësuesit e Kuvendit edhe subjekteve politike, kemi bërë prej ekzekutivit një komision, i cili i merr për bazë kërkesat e bizneseve apo bizneseve të caktuara dhe e kemi këtë Rregullore, të cilën pajtohem unë plotësisht ku së paku dy anëtarë prej komisionit është konflikt interesi. Pllakat e betonit qëllon të bëhen të dielave, nuk qëllon të dielave, po qëllon vetëm në qoftë se planifikon me e bë të dielën pllakën e betonit, po ekzistojnë planifikime, plani dinamik e tjera e tjera, e bën të enjten, e bën të premten, kur s'mundet me qëlluar me bërë betonimin të dielave. Kjo është njëfarë mënyre që veç të lihet një mundësi për me vazhduar mandej me punuar, njëjtë sikurse pompat e benzinës që është një lloj arsytimi për me mundur me pi kafe, për me pas mundësi me i shit gjëra tjera, edhe i pashë kërkesat ishin më tepër nga pompat e benzinës. Unë e kuptoj që pas një sezoni të analizohen të mirat dhe të këqijat e Rregullores, po ashtu pajtohem që e kemi bërë dëshitim të mbledhja e bërllokut, nuk ka funksionuar, kemi pasur grumbullim, ok, kjo të rregullohet, por të themi se duhet të bëhen disa ndryshime dhe të thuhet se paragrafi 1 është në kundërshtim me paragrafin 2, paragrafi 2 me paragrafin 3, kjo nuk ka logjikë sepse i ka kaluar edhe kjo Rregullore disa filtra. Por, në qoftë se me këto ndryshime, ku na faktikisht po duam t'i bëjmë favore bizneseve e me u thirrë në atë që na ju kemi ndihmuar qytetarëve, ju lutem vetëm këtë mos e thuani.

Florina Çitaku: Do të ishte mirë që infrastruktura ligjore e hartuar nga organet kompetente të zbatohet në ato përmasa sa që të mos kishte nevojë që komunat, jo vetëm e jona po edhe të tjerat, të binin në pozita të tilla sa që duhet të hartojmë Rregullore të posaçme për t'i përkrahur interesat e punëtorëve edhe duke u kujdesur në një masë sa më të madhe të mundshme që të bëjmë neutralizimin e këtyre interesave, do të thotë të punëtorëve dhe të bizneseve, se e dimë se me sfida të ndryshme ballafaqohen të dy këto kategori. Sa i përket Rregullores dhe tash hartimit të draftit, unë e vlerësoj punën e gjithë akterëve të cilët kanë ndikuar e të cilët i kanë evidentuar çalimet dhe si rezultat i tyre edhe komisioni ka arritur në një masë, në një formë profesionale që ta bëjë edhe evitimin e tyre. Unë dua të ndalem tek disa nene. Neni 5 i draftit përcakton që neni 12 përkatësisht paragrafi 4, të eliminohet në tërësi dhe thotë këtu gjatë ditës së diel shoqëritë tregtare për korrektësi sipas nomenklaturës do të do të thotë ky nen përfshin sektorin e ndërtimtarisë. Do të thotë nuk do të punojmë, me përjashtim nëse lëshohet një pëlqim nga organi kompetent. Është mirë të potencohet cili është organi kompetent që ka drejtë ta japë pëlqimin që të punojë ky sektor edhe po e kundërshtoj edhe po të cekej organi kompetent është mirë të kujdesemi dhe të sigurohemi se ka të drejtë ligjërisht një organ kompetent ose vendimi i tij a është më i fuqishëm se sa një Rregullore e Kuvendit, duke pasur parasysh hierarkinë juridike. Po ashtu është edhe një gabim teknik aty te neni 15, që thotë eliminohen nenet 20 dhe 21. Është mirë që këto t'i eliminoni edhe atje te dispozitat ndëshkuese, te neni 33 pastaj tek neni 6 do të thotë për marketet, u diskutua kemi parasysh që të gjitha marketet, pavarësisht se ku operojnë ato, ku zhvillojnë veprimtarinë e tyre, a brenda pompave të derivateve apo do të thotë brenda hapësirës fizike të tyre apo jashtë, ato e kanë statusin e njëjtë ekonomik, gjithashtu e kanë edhe kodin e njëjtë të afarizmit. Andaj është mirë që të jetë një trajtim i njëjtë për të gjithë dhe mos të bëjmë diferencime këtu dhe të kujdesemi se mund ta marrim parasysh që është bërë një marrëveshje

mes dy palëve, mirëpo edhe çdo marrëveshje duhet të kujdesemi se a është në harmoni me legjislacionin. Po ashtu tek neni 14 ju e keni futë si rregull që ta sjellin certifikatën apo pëlqimin e Drejtorisë së Inspeksionit për kushtet minimale. Logjikisht, një biznes kur operon, ai kushtet minimale teknike duhet t'i plotësojë edhe gjatë asaj pjese të kohës kur nuk punon me orë shtesë. Do të thotë, edhe kështu që ai këtë kriter duhet ta plotësojë edhe në atë kohë kur nuk punon me orar shtesë edhe certifikatën e lëshuar nga organi kompetent për emetim të zhurmës, mendoj që kjo është më e nevojshme të kërkohej, se këto veprimtari, biznese mundën me krijuar zhurma ose probleme. Organi kompetent duhet të jetë ministria, për mendimin tim, se e ceku drejtori që nuk mundemi ne me ditë ku e marrim, po për mendimin tim duhet të jetë ministria, megjithatë juristët ose profesionistët e fushës besoj që do ta japin mendimin e tyre më profesional.

Ekrem Sadiku: Të gjithë e dini ne si komision kemi punuar gjatë në këtë Rregullore, po ashtu e dini që kjo Rregullore i ka kaluar të gjitha filtrat dhe ka ardhur në Kuvend me propozim ndryshim të propozuara prej anëtarëve të Kuvendit, mirëpo gjatë zbatimit të saj u pa se ka pasur disa defekte, me disa pjesë natyrisht që pajtohëm, mirëpo unë e kam një vërejtje ku me këtë Rregullore po tentohet të lejohen marketet në kuadër të pompave të benzines që të punojnë. Ju e dini që kjo Rregullore ka ardhur si pasojë fillestare nga një petition prej marketeve të vogla, të cilët kanë kërkuar që e diela të jetë pushim. Ne jemi të vetëdijshëm që nuk ka mundësi që kjo Rregullore të përkohet me dëshirën dhe kërkesat e secilit biznes. Mirëpo, të legalizohen ose të lejohen, të punojnë marketet nëpër pompat e derivateve, ku ne e dimë që janë rreth 30 pompa të derivateve në qytetin tonë, e në anën tjetër të mbyllën dyqanet e vogla a është kjo pabarazi? Dhe më tregoni se cili është atëherë efekti i kësaj Rregulloreje andaj kërkoj që të kthehet kjo Rregullore dhe t'i ndalohej puna edhe marketeve të pompave të derivateve, nëse jo atëherë të lejohen edhe marketet e vogla që të punojnë edhe të dielave.

Flutura Beka Kamberaj: Tek neni 3, gjatë ditëve të shtunë, shoqëritë tregtare sipas nenit 9 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4, do të punojnë sipas orarit të përcaktuar gjatë ditëve të punës, ndërsa të dielën nuk do të punojnë, përjashtim janë kodet e Veprimtarisë 10, përpunimi i produkteve ushqimore. Kodi 11 është përpunim dhe prodhim i ushqimeve, kështu që domethënë në qoftë se hyjnë përpunimi, prodhimi i ushqimeve kodi 10 duhet të hynë edhe kodi 11. Tek Neni 12, pastaj vjen 13, ndërsa aty shkruan neni 3 është mirë të rregullohet sepse i kemi në kuadër të Rregullores dy nene 3. Ndërkohë tek procesverballi ne i shohim se gjatë diskutimeve publike ka kërkesa të ndryshme të qytetarëve. Tash disa prej këtyre kërkesave janë marrë parasysh, por disa nuk janë marrë parasysh. Ne kishim kërkuar një sqarim nga ana e komisionit apo kryetarit të komisionit se pse nuk i kanë marrë parasysh kërkesat e disa bizneseve të mëdha, të cilat kanë kërkuar që të punojnë, siç është Lux Mall-i, Mitrovica Mall-i, për arsye se po rrezikohet mbyllja e tyre, për shkak se veç i kishin dërguar e-mailat të qiramarrësit, të cilët janë vendosur aty se do të largohen nga ai objekt, për shkak se nuk ka punë, e punën më të madhe e kanë gjatë ditës së diel. E përveç kësaj, është edhe një biznes tjetër që ka bërë kërkesë, është Tekno-Konstrukt SHPK, i cili e ka një tender të madh për furnizimin me materiale gurore të një projekti të madh të hekurudhës, linja 10, Fushë Kosovë, i cili ka kërkuar që ditën e diel, për shkak se nuk i pengon të tjerët t'i mundësohet puna. Kërkojmë sqarime për mos përkrahjen e kërkesave të këtyre bizneseve, ndërsa përkrahjen një pjese e bizneseve të cilët po ashtu kanë bërë kërkesë. Përveç kësaj, unë kërkoj që në qoftë se i lejohej puna marketeve në pompat e derivateve, t'i lejohet edhe së paku një market i madh të punon me rotacion, për shkak se qytetarët kanë nevojë për furnizime dhe furnizimet janë tu i bërë në lagjen e Suhodollit dhe lagjen e Boshnjakëve. Kjo po i bie favorizim i disa bizneseve, ndërsa dëmtrim i bizneseve tjera.

Elidiana Budini Haziri: E sollët Rregulloren e votuam, tani po e sillni me ndryshime me një përqindje shumë të madhe, a mundemi me ditë pse u vonuat thujse një vit, ju është besuar puna se jeni ekspert të kësaj pune. Deri dje kemi thënë mos i leni oligarkët të punojnë dhe punëtorit të thjeshtë mos ti biem në qafë kurse sot po dalim se do të punojnë restaurantet, marketet dua të di a do të punojnë punëtorët e thjeshtë a bën te dimë pse po bëni ndasi, pra nëse lejohet të punohet te Lux Malli aty do të punojnë punëtorët e thjeshtë pra tani jemi në dilemë se a të votohet apo jo, po edhe nëse ju e votoni nuk do të thotë që ju jeni më të dashur për qytetarin. Kërkoj që të tërhiqet dhe të na vije një seancë tjetër e mirë formuluar në shumë pika.

Jeton Ujkani: Propozojë që ditën e diel të punojnë marketet me rotacion.

Florina Çitaku: Unë vlerësoj që rregullativa ligjore nuk hartohet për të mos u ndryshuar. Ajo mund të ndryshojë varësisht nga nevojat e qytetarëve, varësisht nga kërkesat e tyre dhe varësisht nga problematikat që hasen ato gjatë zbatueshmërisë së saj dhe në qoftë se ne e vërejmë që nuk ka mundësi zbatueshmërie në masën e duhur, atëherë mund ta ndryshojmë, pse jo. Edhe duhet të kemi parasysh që është shumë sfiduese edhe për Komunën edhe për Komisionin që të bëjë neutralizimin e kërkesave të punëtorëve dhe të bizneseve, por më së



miri do të ishte kjo që të rregullohej me ligjin, mirëpo edhe atje i dimë sfidat që i kanë ata, mungesën e inspektorëve të punës, e tjerë, e tjerë. Dhe, kështu që unë përshëndes ndryshimet, po më vjen mirë që janë bërë ndryshimet, e di që e kemi pasur parasysh këtë neutralizim të interesave të tyre, mirëpo tash me këto ndryshime është bërë akoma një neutralizim i kërkesave në mes të interesave të punëtorëve dhe bizneseve dhe kështu që mund të vazhdojë të procedohet.

Hamdi Hasani: Sa i përket Rregullores që u hartua po flitet që e kemi vonuar që 1 vit mirëpo e vërteta është që kjo Rregullore që e kemi votuar ne nuk është hartuar, por është ndryshuar rrënjësisht, sepse para nesh Komisioni e ka prurë një Rregullore për të cilën unë mendoj që ka qenë antikushtetuese, antiligjore, antinjerëzore, duke i lejuar që disa marketet të mëdha të punojnë dhe tjerë duke i sanksionuar. Atë ditë i kemi bërë të gjitha ndryshimet nën për nën dhe i kemi kërkuar nga ata që ta harmonizojnë këtë. Natyrisht pajtohemi plotësisht për ndryshimin për çështje të ndërmarrjeve publike, pajtohemi për shumicën e këtyre gjërave që u thanë, mirëpo na jemi duke vendosë një rregull të ri dhe natyrisht deri sa të mësohen qytetarët, duhet me pas pak konsistenca. E diela duhet të jetë pushim. Pajtohemi plotësisht nuk mund të ndryshojë për të gjitha marketet, për të gjitha tjerat, përveç këtyre çka i kemi specifikuar. Nuk ka qenë e nevojshme të diskutohet sot për furrat e bukës, kur vendimi jonë ka qenë që ato duhet të punojnë atë ditë. Natyrisht, Kryetari edhe Komuna duhet të ketë një të drejtë të veçantë për raste specifike, sepse ndodh gjithçka, ta ketë të drejtën e vet me marrë vendime. Është shumë normale, mirëpo unë jam i pajtimit që çështja e marketeve mos të diskutohet më, të jetë pushim për të gjithë, dikush të punojë dikush jo kështu nuk jemi të drejtë. Absolut është jashtëligjor dhe në momentin e parë ne humbim çdo rast në këtë drejtim nga një palë tjetër që bën ankesë.

Kushtrim Zeneli: Përshëndetje për gjithë, e vërteta se deri te këto pakënaqësi dhe te këto probleme kemi ardhur pikërisht për arsye se një komision që e kemi votuar ne këtu dhe i cili ka punuar përafërsisht tetë muaj dhe në fund kur e ka sjell Rregulloren është injoruar tërësisht dhe janë propozuar pikat aty për aty, por ajo që ka ndodhë atë ditë në Kuvend ka qenë jo etike dhe jo profesionale. Prandaj kemi ardhur në këtë situatë ku i tërë qyteti është në situatë të rëndë. Unë propozoj që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës sepse nuk ka efekt që një market të punojë, apo një minimarket i pompave të benzinës të punojë, e një tjetër jo. Ose të mbetet si propozim tek neni 14 të punojnë edhe minimarketet familjare. Pra, kjo Rregullore, kur është përpiluar atëherë, është përpiluar pikërisht për me zvogëluar pabarazinë në mes punëtorëve, ndërsa sot, nëse kjo Rregullore votohet dhe fuqizohet ky votim po e rrit pabarazinë mes tyre. Edhe një herë po e theksoj që kjo pikë kërkoj të tërhiqet ose të votohen vetëm pikat siç janë menaxhimi i mbeturinave dhe tek uji.

Vesel Neziri: Thënë të drejtën, rrallë pajtohemi me diskutimet e z. Zeneli, por kësaj radhe ia dha hakun, sepse tetë muaj të punosh edhe të vish brenda një ore dhe ta ndryshosh krejt Rregulloren pra në këtë rast unë prita që znj. Kamberaj Beka do të reagon si kryetare e Komisionit. Së dyti, shumë herë po përmendet që marketet punojnë në Suhodoll, Suhodolli është pjesë e komunës jugore dhe në qoftë se marketet ndalohen në Mitrovicën jugore, andaj i lus Drejtorinë e Inspektionit që as në Suhodoll të mos lejohen që të punojnë. Pra unë kërkoj që marketet, nëse nuk punojnë mos të punojnë as pompat e derivateve dhe asnjë market tjetër.

Shkurta Shosholli Musa: Në qoftë se ndalemi të mendojmë atë çka ne kemi parë si praktikë në Kuvend, të paktën këto dy mandatet e fundit, herë-herë jemi ndesh me këto situatat kur e momentit ka qenë kur ka ardhur propozimi, është votuar dhe mandej në praktikë ka qenë i vështirë realizimi. Jo se dua me përmend shtatoren, bustin, nuk po më kujtohet saktësisht emërtimi i propozimit në lidhje me "Adem Jasharin", mirëpo kjo është një prej propozimeve prej mandatit të kaluar që ende në praktikë nuk e shohim. Mendoj që kjo është një praktikë e keqe e Kuvendit. Unë mendoj që minimumi një market me rotacion duhet të punojë, përveç pikave tjera, përveç anës që mendoj që ndryshimi i Rregullores është bërë më shumë se 30%. Në qoftë se ndryshohet mbi 30%, atëherë nuk është më ndryshim, po është hartimi i një Rregulloreje të re dhe procedurat e dimë se cilat janë për një Rregullore të re. Ju lutem, njerëzit ballafaqohen me probleme të ndryshme. Njerëzit ballafaqohen përgjatë një dite e njëzet e katër orësh me situata të ndryshme që herë-herë është i nevojshëm edhe furnizimi. Për më tepër, mbi bazën e asaj që ta ruajmë punëtorin, nuk mundesh me shtrydhë qytetarin. Është një institucion, është Drejtoria e Inspektionit që jo rastësisht në ditën që e kemi pas në votim buxhetin, unë kam kërkuar të paktën tri-katër vetura, në mënyrë që me mujt me operu në pjesë të ndryshme të qytetit, është puna e Drejtorisë së Inspektionit që të përcjell oraret e punëtorëve dhe të drejtat e tyre. Ka institucion që përcjell mirëqenien e qytetarit në vendin e punës. Me dije ose pa dije po i favorizojmë bizneset në dalje të qytetit të Mitrovicës ose komunave të tjera. Këto ishin vetëm disa prej vërejtjeve, realisht Rregullorja ka një numër të konsiderueshëm të vërejtjeve, po në rrethana të tilla, në pikën kritike të kësaj Rregulloreje, na duhet me këqyrë anën humane, domethënë edhe me i tejkaluar të gjitha politikat përballë kësaj Rregulloreje.

Kryetari Bedri Hmaza: I mirëkuptoj diskutimet për këtë Rregullore, të drejtën nuk ka as gjasë teorike as në publik, as në biznese, as mes vete, me ardhë në një pikë të përbashkët. Normalisht që ka shumësi të mendimeve dhe është mirë, unë po ua tregoj një rast personal, një ditë të diele u takova me disa qytetarë posa dola në rrugë, u ankuan e thanë keq që janë mbyllë bizneset, po kur shkuam në një objekt hotelier, punëtorët e tij më thanë: Pse kryetar nuk po na bënë edhe neve pushim. edhe tash është vështirë me menduar që kemi ardhë në një konsensus me të gjitha bizneset edhe në një konsensus mes neve për këtë çështje. Ka pas nevojë me bërë plotësim-ndryshimin e Rregullores, definitivisht po, se janë lëshuar disa çështje që realisht kanë qenë problematike për funksionimin e jetës në qytet. Mendoj që drejtori i dha sqarimet e nevojshme edhe kemi lënë mundësinë që në raste të caktuara kemi mundësi që të bëjmë edhe veprime të caktuara. Sa i përket konfliktit të interesit, mendoj që ne mund të kemi mendimet tona, unë i vlerësoj po për me konstatuar a ka a s'ka, nuk jemi në situatë. Prandaj, çka unë po ju lus, po ju lus që të njëjtën me e përkrahë me proceduar tutje, nëse vërejmë, kushdo prej juve ka të drejtë, edhe na që me ardhë me propozime të arsyetuara që diçka s'është tu funksionuar, tamam nuk ka shanse me na ra as neve e kurrsesi biznesit, nuk ka mundësi me thanë hajde ju me një propozim edhe na po veprojmë sipas kërkesave tuaja. Andaj, po ecim në proces. Nëse vërejmë që diçka s'është mirë, jemi këtu, të njëjtën prapë e trajtojmë.

Elvis Feka: Unë ju falënderoj sinqerisht të gjithë asamblistëve për fjalët që i dhatë dhe komentet që i patët lidhur me këtë Rregullore. Qëllimi edhe i juaji, edhe i joni është që kjo Rregullore me qenë e zbatueshme edhe me qenë në funksion, për çfarë veçse është hartuar. Sa i përket çështjes së barnatoreve, është e rregulluar me Rregullore tjetër që e kanë të caktuar për punën e tyre. Ndërsa për çështjen e specifikave për veprimtaritë e ndërtimitarisë, në këtë pikë është organi kompetent, në këtë rast është drejtoria DPU që është në nenin 14 të cekur, pika 2 dhe pika 5 që sqaron edhe diskutimin që e kishte asamblistja znj. Xhemajli për çështjen e secilit organ, do të jetë organ kompetent për çështjen e lëshimit të këtij dokumenti. Sa i përket kundërshtimit dhe kundërthënive mes paragrafëve, gjithë e dinë, ata çka janë juristë, e dinë më mirë se nëse vjen në pyetje diskutimi i një neni brenda saj, vlen normalisht neni i cili ka dispozitë më pozitive për palën, d.m.th hyn në fuqi. Në këtë rast, nuk kemi dashtë me e lanë me dy kuptimësi. Po flas për çështjen e neneve që patën kundërthënie, siç është neni 10, ku flet për furnizimin me rrymë, me gaz edhe produkte tjera. Po flas për nenin njëmbëdhjetë, që flet për ujë, kanalizim edhe mbeturina. Të gjitha këto nene janë në kundërshtim njëra me tjetrën dhe ne potencialisht nuk kemi as kompetencë të flasim për çështjen e orarit të punës së këtyre veprimtarive që lidhen me shërbime për qytetarin. Sa i përket çështjes së emetimit të zhurmës e kemi diskutuar si temë dhe është problematike me marr biznesi një vërtetim për çështjen e zhurmës. Edhe çështja e përqindjes është çështje që ka qenë e rregulluar me një udhëzim administrativ, mirëpo me hyrjen në fuqi të udhëzimeve të reja është shfuqizuar përqindja e ndryshimit të akteve nënligjore dhe ligjore në kuadër të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Kryesuesja hedh në votim propozimin që marketet të punojnë të dielave me rotacion.

#### **Rezultati i votimit 4 - për, 16 - kundër dhe 0 - abstenime.**

Kryesuesja konstaton se nuk kalon propozimi që marketet të punojnë të dielave me rotacion.

Kushtrim Zeneli: Kryesuese nëse nuk doni me i hedh në votim veç e veç, atëherë unë e tërheq propozimin.

Elvis Feka: Sa i përket kërkesës së trajtimit të një kërkesë që është për gurë thyes, në këtë rast kjo trajtohet me nenin e fundit, ku e kemi plotësuar që në investimet publike lejohet puna, pra që kanë kontratë publike me operatorë.

Kryesuesja hedh në votim Propozimin për miratimin e Rregullores për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 07/2023 Për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në Komunën e Mitrovicës së Jugut, me të gjitha potencimet e cekura nga drejtori z.Elvis Feka dhe ato që i potencoj znj. Kamberaj Beka.

#### **Rezultati i votimit 18 - për, 7 - kundër dhe 0 - abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar Rregulloren për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 07/2023 Për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive tjera në Komunën e Mitrovicës së Jugut.**

### Pika 3

Kryesuesja sa i përket Propozim vendimit për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023/2024, fillimisht më lejoni ta falënderoj Kryetarin e Komunës së në KPF ka ardhur propozimi me 180 bursa, ndërsa Kryetari ka propozuar që ky numër të rritet me 230 bursa dhe siç e dini propozim vendimi e parashih formimin e komisionit për ndarjen e bursave përbëhet nga 5 anëtarë, tre anëtarë nga kuvendi dhe dy nga ekzekutivi.

Nafije Rexha: Sa i përket kësaj çështjeje, prapë Kryetari po dëshmon se është për mësimdhënie, është për arsim cilësor, ky hap i Kryetarit që prapë po ngritet fondi për studentët bursistë, vlen të përgëzohet dhe të miratohet me shumë dashamirësi. Faleminderit, Kryetar, që mendon çdoherë për mësimdhënësit, mendon çdoherë për studentët, sepse në të ardhmen ata do ta përfaqësojnë vendin, kështu që ky hap për neve me përvojë shumë të gjatë profesionale, na gëzon shumë e që besoj që edhe studentët do të ndihen shumë të lumtur në këtë hap shumë domethënës për ta.

Xhyljeta Imeri: Sa i përket bursave, rritja e numrit të tyre është shumë e rëndësishme edhe presim që çdo vit të kemi rritje të numrit përfitues të bursave, duke marrë parasysh që bursat përveç e lehtësojnë buxhetin e prindërve, buxhetin familjar, atë edhe i nxisin studentët që të arrijnë rezultate sa më të larta. Dua të theksoj edhe që jam shumë mirënjohëse, dhe ju përgëzoj që e keni rritë numrin e bursave për komunitete, se vetëm në këtë mënyrë, me mbështetjen e tyre në shkollim, ne mund të t'i ngrisim kapacitetet e tyre, po, pse jo edhe në të ardhmen të kenë pozita vendimmarrëse në komunën tonë.

Shkurta Shosholli Musa: Ka qenë bujë mirëseardhjeje rritja e numrit të bursave vitin e kaluar. Unë po besoj që numri dhe rritja e përsëritshme e numrit të bursave do të jetë edhe një mirëseardhje e dytë përballë studentëve. Shpresoj që në Kuvend, shpejt të vijë edhe Rregullorja për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollës së mesme të lartë teknike "Arkitekt Sinani", me ndryshimet e nevojshme, po ashtu të specifikohet edhe numri i bursave përfitues, uroj që procesi i përzgjedhjes të ju shkojë mbarë ashtu siç ka shkuar në vitin e kaluar.

Kryesuesja Vesa Broja: Atëherë fillojmë me propozimet e kandidatëve për anëtar të komisionit nga përfaqësuesi i G.P. të PDK-së.

Shkëlqim Ibrahim: Për anëtarë të Komisionit për ndarjen e bursave nga radhët e PDK-së propozoj z. Egzon Hamza.

Kushtrim Zeneli: Për anëtarë të Komisionit për ndarjen e bursave nga radhët e LVV-së propozoj znj. Xhevrije Bahtiri -Ademi.

Flutura Beka Kamberaj: Për anëtarë të Komisionit Komunal për ndarjen e bursave nga radhët e LDK-së propozoj z. Gazmend Asllani.

Kryetari i Komunës nga ekzekutivi propozon znj. Drita Kadriu dhe z. Gëzim Stavilevci.

Kryesuesja e Kuvendit: Hedh në votim Propozim vendimin për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023/2024 dhe formimin e Komisionit për ndarje të bursave, me këtë përbërje:

1. Egzon Hamza,
2. Xhevrije Bahtiri Ademi,
3. Gazmend Asllani,
4. Drita Kadriu dhe
5. Gëzim Stavilevci.

**Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2023/2024 duke përfshirë edhe përbërjen e Komisionit për ndarje të bursave.**

### Pika 4

Kryesuesja sa i përket Propozim vendimit për formimin e Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave, Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, dy anëtarë nga kuvendi, dy nga ekzekutivi, dhe një anëtarë nga shoqëria civile, sot pra me pëlqimin e grupit po i lirojmë dy vendet nga Kuvendi, njërin LVV dhe tjetrin LDK.

Elidiana Budini Haziri: Për anëtare të Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave propozoj: znj. Shkurta Shosholli Musa.

Gjergj Beka: Për anëtar të Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave propozoj z. Vesel Neziri.

Shkurta Shosholli Musa: Nuk pranoj të jem e propozuar për Komisionin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë, me kënaqësinë më të madhe edhe me ballin çelë ju dal secilit prej anëtarëve fitues prej listës fituese të studentëve të vitit të kaluar, përsëri po them me përgjegjësinë më të madhe e kemi bërë më të mirën si komision. Nuk është ngulm veç unë të jem pjesë e ndonjë komisioni, është ideologjia e krijuar që në qoftë se flet ti përjashtohesh. Kjo është ideja. Edhe mandej vjen politika që ti vazhdimisht vazhdon të jesh e përjashtuar. Kjo është ideja.

Kushtrim Zeneli: Për anëtar të Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave propozoj z. Ekrem Sadiku.

Kryetari i Komunës për anëtarë të Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave nga ekzekutivi propozon znj. Igballe Islami dhe z. Valdete Idrizi, ndërsa nga shoqëria civile z. Eugen Bimbashi.

Kryesuesja Vesa Broja: Meqenëse nuk kemi propozime të tjera atëherë hedh në votim propozimin për formimin e Komisionit të ankesave për ndarjen e bursave me këtë përbërje:

1. Vesel Neziri,
2. Ekrem Sadiku,
3. Igballe Islami,
4. Valdete Idrizi dhe
5. Eugen Bimbashi.

**Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për formimin e Komisionit e Komunal të ankesave për ndarjen e bursave.**

#### Pika 5

Kryesuesja e Kuvendit sa i përket sqarimit të Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Klubin e Xhudos “Trepça”, pa procedura konkurrimi, fjalën ia kaloi drejtoreshës znj. Valdete Idrizi.

Valdete Idrizi në pika të shkurta e sqaroi Propozim-vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Klubin e Xhudos “Trepça”, pa procedura konkurrimi.

Armend Begu: Lokacionin nuk e patëm në material, ajo po na intereson, është shumë vendim i mirë, ju ftoj të gjithë ta votojmë.

Valdete Idrizi: Lokacioni është afër shkollës amerikane. Edhe dokumentet i kemi, edhe projektin e kemi.

Xhevrije Bahtiri Ademi: Unë edhe dy mandate të mëhershme kam qenë një zë i ngritur në Kuvend për këtë klub të qytetit tonë, sepse vendi ku stërviten ata është një vend që në të vërtetë mungon oksigjeni dhe hapësira është shumë e vogël. Sporti xhudos në të vërtetë na bën krenarë neve si Mitrovicë, sepse edhe vetë trajneri ka qenë emblemë e këtij sporti në nivel Kosove, por edhe në nivel ish-Jugosllavisë. Andaj, ne e përkrahim plotësisht dhe me të drejtë, sepse sportistët tanë sot po ngritin medalje të arta nëpër vendet botërore.

Jeton Ujkani: Është shumë i mirëseardhur ky investim në komunën tonë dhe dëshirojmë sa më shpejt të arrihet, unë vetëm e kam një pyetje, se e kemi pa procedura të konkurrimit, a kemi dokument ministrie që mos me pas telashe mandej, kështu që nëse kemi dokument, jemi në rregull atëherë.

Valdete Idrizi: Të gjitha dokumentet e nevojshme i kemi të siguruar, po ashtu në material i keni të bashkangjitura.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Klubin e Xhudos “Trepça”, pa procedura konkurrimi.

**Rezultati i votimit: 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Klubin e Xhudos “Trepça”, pa procedura konkurrimi.**

#### Pika 6

Kryesuesja e Kuvendit sa i përket sqarimit të Propozim-vendimit për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-44690/9 dt. 29.06.2023, fjalën ia kaloi drejtorit z. Artan Berisha.

Artan Berisha në pika të shkurta e sqaroi Propozim-vendimin për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-44690/9 dt. 29.06.2023.

Kryesuesja hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim vendimin për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-44690/9 dt. 29.06.2023

**Rezultati i votimit: 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për shfuqizim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02/06-44690/9 dt. 29.06.2023.**

#### **Pika 7**

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Propozimin për miratim të Planit komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Mitrovicën Jugore 2023-2025.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja hedh në votim Propozimin për miratim të Planit komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Mitrovicën Jugore 2023-2025.

**Rezultati i votimit: 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Propozimin për miratim të Planit komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Mitrovicën Jugore 2023-2025.**

#### **Pika 8**

Kryetari Bedri Hamza: Të nderuar anëtarë të asamblesë, drejtorë, me qëllim që të jemi racionalë në kohë dhe të japim mundësinë që secili asamblist ta bëjë diskutimin e vet, para veti e keni Raportin, i përpiluar dhe i draftuar në bazë të standardeve dhe në kohë. Çka është karakteristike është se trendi i të hyrave ka qenë i kënaqshëm, i pranueshëm dhe kemi një realizim të të hyrave për nëntëmujorin e parë në përqindje 69.4. Është inkurajues fakti që të hyrat e rregullta, sidomos të hyrat nga tatimi, kanë një performancë të mirë dhe kemi një përmbushje të planit prej 88.26 % dhe të hyrat nga kadastri kanë një performancë të mirë që e kemi një tejkalim planit që deri më tash e kemi një përmbushje të planit prej 144.83 % inkasim, në disa kategori që nuk është në dinamikën me planin, kryesisht që lidhet me lejet e ndërtimit, ku për këtë periudhë të vitit kemi një përmbushje të planit prej 41%, por kur e shohim total, në disa vende kemi një performancë më të dobët, në disa vende kemi një performancë më të mirë dhe pritjet janë që deri në fund të vitit të kemi një përmbushje të planit afërsisht ashtu qysh është e planifikuar në buxhet. Sa i përket pjesës së shpenzimeve, te pagat dhe mëditjet kemi një ekzekutim prej 76%, kjo ka ardhur si rezultat i Ligjit të pagave, ku koeficientet janë caktuar pasi që është aprovuar buxheti dhe ka një impakt në këtë çështje dhe janë disa Urdhra Përmbarimore për çështje që njerëzit nuk i kanë realizuar të drejtat e tyre në kohë, sipas kontratave kolektive dhe i kanë ekzekutuar dhe vazhdojnë t'i ekzekutojnë përmes urdhrave përmbarimore. Po këtu nuk kemi ndonjë problem, për shkak se Ministria e Financave ka të drejtën që si rezultat i ndryshimit të komponentit të pagave, organizata buxhetore t'ia plotësojë pjesën e mbetur. Te mallrat dhe shërbimet është një ekzekutim prej 65 %, unë besoj që të gjithë operatorëve ekonomikë deri në fund të vitit do t'i kryhen pagesat dhe nuk do të ngelen obligimet e paguara në përjashtim të faturave të dhjetorit, të cilat do të vijnë në janar. Te subvencionet kemi një progres të mirë 81 % dhe çka është inkurajues fakti që te investimet kapitale në total, duke i përfshirë të gjitha burimet e financimit, kemi një ekzekutim prej 43 % dhe kemi një ekzekutim të mirë të buxhetit në Komunën e Mitrovicës, që sigurisht do të jetë mbi 80 %. Nëse ngelet diçka e pashpenzuar prej të hyrave vetanake, do të thotë është mundësia e bartjes, ndërsa jemi të fokusuar që pjesët e grantit t'i shpenzojmë maksimalisht, për çka do të jetë pikë e radhës. Këtu i kemi specifikat edhe kur është ekzekutimi i buxhetit përmes urdhrave përmbarimore, çka është me rëndësi të theksohet kemi një zvogëlim të këtij pozicioni në raport me periudhat paraprake, derisa në vitin 2022 kemi pasur mbi 2,000,000 € ekzekutime prej buxhetit përmes urdhrave përmbarimore, këtë vit i kemi mbi 500,000 € dhe janë të specifikuar se për cilat kategori dhe për cilat urdhrat përmbarimore kanë shkuar këto mjete.

Hysen Muzliukaj: Raportit financiar, çka është e vërteta i mungojnë detyrimet, obligimet. Nuk e di pse, është hera e dytë, kujtoj, edhe pas gjashtëmujorit edhe pas nëntëmujorit nuk po bashkëngjiten detyrimet. Në ueb faqe të komunës i pashë, ka kode, për shembull, që s'ka nisë asnjë projekt, por janë marrë parat, rast specifik

është shkolla e Gjimnazit, aty thotë realizueshmëria 39 %, i bien që janë marrë për shkak të urdhrave përmbartimore, urdhrat përmbartimore e shoh që janë të vitit 2023 dhe 2022 shumica shuma 542.000 €. Çka ka ndodhë se kur e pashë te obligimet në ueb faqe të komunës, e lexova për shkak të mungesës së mjeteve, që po i bien gati 542,000 €, edhe aty ishin nja 500,000 €, e po i bie mbi 1,000,000 € borxh, për shkak të mungesës së mjeteve, thuajse nuk janë paguar fatura, me meqenëse e pashë edhe operatorin “Madekos”, e lypa përmes ARBK-së, nuk e gjeta, me siguri e ka emrin tregtar “Madekos”, por në ARBK e ka emrin tjetër, nuk e di për çka ka të bëjë, ndoshta me shëndetësi. Si raport, po konstatojmë që prapë po vazhdon avazi i urdhrave përmbartimore, nuk është krejt që jena ok. Unë pata bërë një pyetje vitin e kaluar në fund të 2022 a jena pastër tash me borxhe edhe më keni thonë po, e në bazë të këtij raporti i bie që jena mbi 1,000,000 € borxh, pasi që 542,000 € janë marrë edhe mbi 500,000 € s'ka mjete, pritet me u marrë.

Kryetari Bedri Hamza: Do të thotë gjithmonë na duhet të jemi të kujdesshëm që t'i bëjmë planifikimet e shpenzimeve në përputhje me buxhetin dhe unë kërkoj që ekzekutivi mos të shkoj në shpenzime përtej ndarjeve buxhetore, mirëpo është evident fakti që kemi një zvogëlim drastik të ekzekutimeve përmes urdhrave përmbartimore, pastaj një pjesë e madhe këtu i kemi të shpenzuara si rezultat i kontratave kolektive, që unë e kam thënë gjithmonë komunat veç e paguajnë këtë barrë, përndryshe se kanë krijuar këtë obligim. Por, sidoqoftë besoj që deri në fund të vitit ne do të arrijmë edhe përmes riorganizimit të buxhetit që ne mos t'ju ngelim borxh operatorëve të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale me Komunën e Mitrovicës. Do të jemi shumë të kujdesshëm që maksimalisht të gjitha obligimet t'i kryejmë në kohë. Ekziston mundësia që disa detyrime kanë ngelë pa u paguar për shkak mosplotësimit të aspektit administrativ, por nuk do të thotë kjo që borxhet janë të njëjta në tetor në raport me shtatorin, sepse një pjesë e pagesave veç është ekzekutuar.

Xhyljeta Imeri: Edhe unë do të ndalem në pika të shkurtra duke marrë parasysh kohën dhe pse disa sqarime i kemi marrë edhe në Komitet për Politikë dhe Financa. Tek shpenzimet e Kuvendit e kemi pa që janë tejkualuar mbi 120%, po e kuptuam që është në pyetje rritja e pagave. Te inkasimi, në disa drejtori është tejkualuar planifikimi si në DGJKP, po ka edhe në disa drejtori që është një shumë minimale, por presim deri fund vitit ndoshta do të kenë ndonjë përparim. Tek investimet kapitale ka një rritje në krahasim me raportin e gjashtë mujorit të parë, por prapë nuk ka kaluar 50 %, por presim që deri në fund vitin ndoshta edhe në këtë kategori do të kemi investime më të larta, duke marrë parasysh që janë shumë rrugë, shumë projekte duke u investuar në to. Dhe janë disa kode që këtu paraqiten që janë shpenzuar 96 %, 100 %, mbi 70 %, por realisht ne nuk i shohim që janë duke u punuar. Na intereson me marr një sqarim për çfarë arsye janë të dokumentuara kështu, po realiteti është ndryshe, p.sh. kodi të “Parku Panoramik”.

Kryetari Bedri Hamza: Atëherë, sa i përket performancës së të hyrave, e thashë që është 69.4 për qind, unë po them se kemi një përmbushje të mirë të planit të të hyrave. Në disa kategori, p.sh. te lejet e urbanizimit, na e planifikojmë, por nuk varet krejt prej neve sa kanë me aplikuar për leje, dhe sa i plotësojnë kushtet për leje. Çka kemi arritur deri tash, është mirë që deri në këtë moment kur po flas kemi arritur me i ikë keq klasifikimit që urdhrat përmbartimore kapitale janë të ekzekutuara prej shpenzimeve kapitale, urdhrat përmbartimore në kategori tjera, janë në kategori tjera. Dhe e tha edhe z. Muzliukaj, për shembull, nëse na e shikojmë Gjimnazin në dokumentacion, na del që jemi duke punuar aty, po në fakt, Gjimnazin se kemi filluar, për shkak se është bërë ekzekutim përmes urdhrat përmbartimor për një projekt tjetër. Në fund të raportit financiar, sigurisht se do ta kemi të qartë secili pozicion për çfarë është shpenzuar.

Naser Muja: U cek se urdhrat përmbartimor shkuan në klasifikime të duhura, unë po e shoh që në një prej investimeve kapitale janë marrë mjetet nga mallrat dhe shërbimet, janë dy pozicione. Kompania “Bageri” është krejt një investim kapital, a ekzekutimi u bë nga mallrat dhe shërbimet. Nëse është veç pjesa e kamatës ndërsa ekzekutimi i përgjithshëm është prej investimeve, është në rregull, e kundërta, dalim keq dhe ndikon në opinion.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e mbledhjes vuri në votim Raportin financiar për periudhën janar-shtator 2023.

**Rezultati i votimit: 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar Raportin financiar për periudhën janar-shtator 2023.**

## **Pika 9**

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Raportin e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave Lokale.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim propozimin e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave Lokale.

**Rezultati i votimit: 24 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e konstatoi të miratuar Raportin e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave Lokale.**

#### **Pika 10**

Kryesuesja e mbledhjes ia kaloi fjalën Kryetarit të Komunës për ta arsyetuar Propozim-vendimin për transferin e shumave të ndara buxhetore.

Pas arsyetimit nga ana e Kryetarit, Kryesuesja hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për transferin e shumave të ndara buxhetore.

**Rezultati i votimit: 22 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e mbledhjes e konstatoi të miratuar Vendimin për transferin e shumave të ndara buxhetore.**

#### **Pika 11**

Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për caktimin e hapësirës publike për vendosjen e Shtatores së ish futbollistit Erion Kajtazi.

Xhevrije Bahtiri Ademi: Kryesuese, moralisht më takon me folë për personalitetin e Erion Kajtazit. Ai ka qenë nxënësi imi dhe vërtet humbja e tij ka qenë humbje e krejt qytetit tonë, por edhe më tej. Eroni ishte me të vërtetë një nxënës i mrekullueshëm, por që bie në sy ishte edukata e tij. Humbja e tij ka prekë shumë komunitetin sportiv, jo vetëm në Kosovë, por edhe më tej. Ngritja e kësaj shtatoreje besoj që është gjëja më e mirë që mund të ndodhë, sepse është stimulim për të rinj se si mund të arrijë një gjashtëmbëdhjetë a shtatëmbëdhjetëvjeçar që të prekë majat e suksesit edhe ndërkombëtar. Kështu që unë me zemër edhe me një ndjenjë shumë të rëndë se për një vit nuk kam mundur të hyjë në atë klasë, e ndjenjë një dhimbje, sikur të ishte një fëmijë imi. Kështu që më vjen mirë për këtë iniciativë dhe e përkrahi me tërë qenien time.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për caktimin e hapësirës publike për vendosjen e Shtatores së ish futbollistit Erion Kajtazi.

**Rezultati i votimit: 25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesja e mbledhjes e konstatoi të miratuar Vendimin për caktimin e hapësirës publike për vendosjen e Shtatores së ish futbollistit Erion Kajtazi.**

#### **Pika 12**

##### **Pyetje dhe përgjigje**

Gazmend Asllani: Çështje të cilën e kam ngrit shqetësimin edhe para disa seancave dhe ende nuk kemi marr një përgjigje, është fjala është për trotuarin në Fshatin Rekë i cili është tmerrësisht në gjendje të keqe. Pra as nuk është ndërmarr diçka?, kanë kaluar gjashtë muaj as përgjigje nuk kemi marr, po ashtu edhe trotuari në Rekë është i pa pastruar. Tribuna e quajtur "VIP Tribuna" në sallën "Minatori" si u ndërtua dhe a ka pas ekspertë që e kanë konstatuar sigurinë e asaj tribune? Kisha dashtë një raport prej DKRS-së me na sjellë në seancën e ardhshme, në të njëjtën kohë do ta shpreh edhe shqetësimin e punëtorëve të sallës, është vendosja e 10 kamerave, e cila menaxhohet nga klubi basketbollistik Trepça. A është kjo e lejueshme apo jo? Pra edhe një herë po e theksoj se kërkoj që për seancën e radhës të na sjellët një raport i detajuar, pra kush është financuesi i asaj tribune, a ka pas tender por edhe të gjitha çka i përket sallës "Minatori".

**Mbledhja përfundoi punimet në ora 12:40 min.**

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Afërdita MAXHUNI

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

